



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER GJERGJ R. KONGOLI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 10, RR. MIHAL DURI
TEL: 0682033057

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 4338

Nr. koleksioni: 1752


Tirane më 11/08/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022053630183028310



A2022053630183028310

**KONTRATË SHITBLERJE
KUOTASH KAPITALI**

Sot më datë 11.08.2022 (dymijë e njëzet e dy), para meje noterit publik, Gjergj Kongoli, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, në zyrën time noteriale të ndodhur në Tiranë, u paraqitën personalisht palët kontraktuese të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar) dhe statutit të shoqërisë "BLUE BEACH RESTAURANT" SHPK, me kushtet e mëposhtme:

I. PALËT

Pala Shitëse:

Ardjan Alimeri, atësia Shyqyri, amësia Shefiko, shtetas Shqiptar, lindur në Çorovodë, Skrapar dhe banues në Tiranë, me adresë Irfan Tomini; Njësia Administrative Nr. 5; 0000; Tiranë, lindur më 12/07/1969, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037253457 dhe nr. personal G90712054C, i cili paraqitet në këtë kontratë në cilësinë e ortakut të shoqërisë "BLUE BEACH RESTAURANT" SHPK.

Dhënëse Pëlqimi:

Gentjana Alimeri, atësia Maksim, amësia Mamude, shtetase Shqiptare, lindur në Çorovodë, Skrapar dhe banuese në Tiranë, me adresë Irfan Tomini; Njësia Administrative Nr. 5; 0000; Tiranë, lindur më 24/07/1977, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 037258015 dhe nr. personal H75724049M, e cila paraqitet në këtë kontratë në cilësinë e bashkëshortes së z. Ardjan Alimeri dhe për rrjedhojë bashkëpronare, për efekt martesë, në kuotën që z. Ardjan Alimeri zotëron në shoqërinë "BLUE BEACH RESTAURANT" SHPK.

Pala Blerëse:

Shoqëria Curri Group, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M214090190; me seli në adresë Autostrada Tirane Durrës, Km. 3, Zona Kadastrale 2679, Nr. Pasurie 19/27/1, përfaqësuar nga Administratori Eduard Curraj, atësia Gjon, amësia Shaqe, shtetas Shqiptar, lindur në Jeran, Shkodër dhe banues në Malësi E Madhe, me adresë Ndrecaj; Nd. 001; Kastrat; Bajzë; 4306; Malësi E Madhe, lindur më 13/10/1973, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033871246 dhe nr. personal H31013028R.

Kushtet Paraprake

- a) Shoqëria "BLUE BEACH RESTAURANT" SHPK, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është regjistruar si person juridik pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar më datë 05.11.2021, dhe është mbajtëse e Certifikatës së Regjistrimit NUIS (NIPT) M123055060, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), me zyrë qendrore në Durrës, Ishëm, Lalez, Rruga Drac, Ndërtesa ne Zonën Kadastrale Nr. 1522, Nr. Pasurie 129/64 ND, Lalez, me kapital të regjistruar 100,000 Leke (njëqindmijë) lekë, me administrator z. Ardjan Alimeri, me 1 ortak z. Ardjan Alimeri, zotërues i 1 kuote e cila përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;



- b) Pala shitëse është e interesuar t'i shesë palës blerëse 67 % te pjesëve te kapitalit të regjistruar të shoqërisë "BLUE BEACH RESTAURANT" SHPK dhe pala blerëse është e interesuar të blejë këtë kuotë;
- Për sa më lart palët bien dakord, për sa vijon:

II. OBJEKTI

2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse z. Ardjan Alimeri, i shet palës blerëse, Shoqërisë "Curri Group" Shpk 1 kuotë që përben 67% te kapitalit themeltar në shoqërinë "BLUE BEACH RESTAURANT" SHPK.

2.2 Pas regjistrimit të kësaj kontrate në QKB, Shoqëria "BLUE BEACH RESTAURANT" SHPK, do të përbehet nga ortaket:

- *Shoqëria "Curri Group" Shpk, e përfaqësuar nga Administratori Z. Eduard Curraj, zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 67% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "BLUE BEACH RESTAURANT" SHPK.*
- *Z. Ardjan Alimeri, zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 33% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "BLUE BEACH RESTAURANT" SHPK.*

III. ÇMIMI

3.1 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së kuotës objekt i kësaj kontrate, është në vlerën e tij nominale, prej 67.000 Leke (gjashtëdhjetë e shtatë mijë Leke), vlerë të cilën Shoqëria "Curri Group" Shpk do ta depozitojë në Llogarinë Bankare të Shoqërisë "BLUE BEACH RESTAURANT" Shpk pranë OTP BANK Sh.A, brenda datës 20/08/2022

IV. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE

- 4.1 Pala blerëse dhe/ose personat e caktuar prej saj ka/në të drejtë të ketë akses në të gjithë dokumentacionin juridik, financiar dhe teknik të shoqërisë "BLUE BEACH RESTAURANT" SHPK.
- 4.2 Pala blerëse detyrohet të paguajë çmimin e parashikuar në nenin 3.1 të kontratës.

V. KALIMI I PRONËSISË

5.1 Palët kanë rënë dakord që kjo kontratë shitblerje kuotash kapitali, të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe Shoqërinë "BLUE BEACH RESTAURANT" SHPK, do të përbehet nga ortaket:

- *Shoqëria "Curri Group" Shpk, e përfaqësuar nga Administratori Z. Eduard Curraj, zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 67% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "BLUE BEACH RESTAURANT" SHPK.*
- *Z. Ardjan Alimeri, zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 33% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "BLUE BEACH RESTAURANT" SHPK.*

5.2 Nga momenti i regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) pala shitëse, humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotën e cila përfaqëson 67% të kapitalit të shoqërinë "BLUE BEACH RESTAURANT" SHPK dhe këto të drejta fitohen nga pala blerëse *Shoqëria "Curri Group" Shpk, e përfaqësuar nga Administratori Z. Eduard Curraj.*



A2022053630183028310

VI. DHËNËSJA E PËLQIMIT

6.1 Dhënësja e pëlqimit znj. Gentjana Alimeri, bashkëshorte e ortakut Ardjan Alimeri dhe bashkëpronare, për efekt martese, në kuotën që Ardjan Alimeri zotëron në shoqërinë "BLUE BEACH RESTAURANT" SHPK, deklaron se është dakord që kuota, objekt i kësaj kësaj kontrate, ti shitet **Shoqërisë "Curri Group" Shpk, e përfaqësuar nga Administratori Z. Eduard Curraj**, dhe pas kësaj shitje palët të procedojnë lidhur me të gjitha ndryshimet e tjera të rëna dakord në këtë kontratë. Dhënësja e pëlqimit znj. Gentjana Alimeri, deklaron se nuk ka asnjë pretendim lidhur me këtë shitje të kuotës dhe nuk do ketë asnjë pretendim në të ardhmen lidhur me sa është rënë dakord në këtë kontratë.

Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një qëndron në arkivën noteriale, një original regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe më pas qëndron në zyrën qendrore të shoqërisë dhe nga një original e merr secila palë.

Kjo kontratë pasi iu lexua me zë të lartë palëve nga unë noteri publik, ata më deklaruan që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua prej tyre në praninë time dhe unë noteri e vërtetoj atë në bazë të ligjit.

PALA SHITËSE

ARDJAN ALIMERI



**DHËNËSJA E PËLQIMIT
GENTJANA ALIMERI**

Gentjana Alimeri
Gent


PALA BLERËSE

**Shoqëria "Curri Group" Shpk
Administrator EDUARD CURRAJ**

Eduard Curraj
Curraj



**NOTER
GJERGJ KONGOLI**





VENDIMI I MBLEDHJES SË ORTAKUT

TË SHOQERISË “BLUE BEACH RESTAURANT” Shpk

Sot, ne Tirane me date 11/08/2022, Asambleja e Ortakeve te Shoqerise BLUE BEACH RESTAURANT Shpk, e perbere nga:

Ortaku

Ardjan Alimeri, atësia Shyqyri, amësia Shefiko, shtetas Shqiptar, lindur në Çorovodë, Skrapar dhe banues në Tiranë, me adresë Irfan Tomini; Njësia Administrative Nr. 5; 0000; Tiranë, lindur më 12/07/1969, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037253457 dhe nr. personal G90712054C.

Me pjesëmarrjen e

Shoqëria Curri Group, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M214090190; me seli në adresë Autostrada Tirane Durres, Km. 3, Zona Kadastrale 2679, Nr. Pasurie 19/27/1, përfaqësuar nga Administratori Eduard Curraj, atësia Gjon, amësia Shaqe, shtetas Shqiptar, lindur në Jeran, Shkodër dhe banues në Malësi E Madhe, me adresë Ndrecaj; Nd. 001; Kastrat; Bajzë; 4306; Malësi E Madhe, lindur më 13/10/1973, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033871246 dhe nr. personal H31013028R.

Te cilët shqyrtuan

Rendin e Ditës:

- Shitjen e 1 kuote 1 (një) kuote e cila përfaqëson 67% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë “BLUE BEACH RESTAURANT” SHPK, nga ortaku Ardjan Alimeri ne favor te palës blerës Shoqerise Curri Group Shpk e përfaqësuar nga Administratori Z. Eduard Curraj.
- Vlera e shitje se kuotës do jete ne vlerën nominale 67.000 Leke (gjashtëdhjetë e shtatë mijë Leke), vlere te cilën Shoqëria Curri Group Shpk e përfaqësuar nga Administratori Z. Eduard Curraj do ta depozitoje ne Llogarinë Bankare te Shoqërisë “BLUE BEACH RESTAURANT” Shpk pranë OTP BANK Sh.A, brenda datës 20.08.2022.

Mbledhja pasi mori ne shqyrtim rendin e dites, palet bien dakord, dhe vendosin:

VENDOSI

1. Miratimin e rendit të ditës.
2. Transferim me ane te shitjes se 1 kuote 1 (një) kuote e cila përfaqëson 67% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "BLUE BEACH RESTAURANT" SHPK, nga ortaku Ardjan Alimeri ne favor te palës blerës Shoqeria Curri Group Shpk e perfaqesuar nga Admnsitratori Z. Eduard Curraj.

Për sa sipër, mbyllet, mbledhja e Asamblesë se Ortakut te Vetëm dhe nënshkruhet prej tyre.

ORTAKU I SHOQERISE "BLUE BEACH RESTAURANT" SHPK

Z. Ardjan Alimeri



I PRANISHËM

Shoqeria Curri Group Shpk

Z.Eduard Curraj

Eduard Curraj

